



**AMBULANCA
MOBILE
PËR SHËRBIME
GJINEKOLOGJIKE**

HERAA – Asociacion për edukim shëndetësor dhe hulumtim, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë në ambulancën mobile për shërbime gjinekologjike i ofron këto shërbime pa pagesë:



1. KONSTATIMI DHE SHËRIMI I INFEKTIME SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

INFEKTIME SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME:

Siç thotë edhe vetë fjala, këto janë infektive që transmetohen përmes marrëdhënies seksuale të pambrojtura (pa prezervativ), gjegjësisht përmes kontaktit të organeve gjenitale. Por, disa infektive seksualisht të transmetueshme mund të transmetohen edhe përmes peshqirëve të përbashkët, rrobave të brendshme, sfungjerëve për banjë etj.

Infektimet më të shpeshta seksualisht të transmetueshme janë: klamidi, gonorea, trihomoniazë, sifilisi, HPV (human papiloma virusi) dhe HIV (virus që shkakton SIDA).

Disa nga infeksionet seksualisht të transmetueshme, nëse mjekohen në kohë, mund të shkaktojnë pasoja serioze për shëndetin e njeriut, si për shembull, sterilitet (pamundësi që të krijojë trashëgimi). Ekzistojnë infektive seksualisht të transmetueshme, gjatë të cilave mund të mos paraqiten kurfarë shenjash (simptoma), derisa disa prej tyre shfaqin shenja. Menjëherë duhet të drejtoheni te mjeku nëse i vëreni shenjat që vijojnë:

- ekstrakt i pazakonshëm nga penisi, gjegjësisht vagjina, i cili është i përcjellë me aromë të pakëndshme, dendësi dhe ngjyrë të pazakonshme;
- dhimbje gjatë marrëdhënies seksuale;
- paraqitja e skuqjes, të rrojturit në pjesën e parme të gjenitaleve (organet seksuale);
- të pickuarit, dhimbje ose urinim i shpeshtë;

- dhimbje në pjesën e stomakut dhe të legenit;
- gungë (lyth) rreth vagjinës dhe anusit;

PARANDALIMI NGA INFEKTIMET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

Përdorimi i rregullt dhe i drejtë i prezervativit e zvogëlon rrezikun nga fitimi ose transmetimi i infektiveve seksualisht të transmetueshme. Gjithashtu, prezervativi paraqet edhe mjetin e vetëm që njëkohësisht mbron nga shtatzënia e padëshiruara dhe nga infektimet seksualisht të transmetueshme.

KONSTATIMI I INFEKTIVEVE SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

Në ambulancën mobile për shërbime gjinekologjike bëhen teste për infektimet seksualisht të transmetueshme.

MJEKIMI I INFEKTIVEVE SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

Në bazë të rezultateve nga kontrollimet, mjeku do t'ju japë terapi pa pagesë. Nëse gjendja e konstatuar nuk lejon mjekim në kushte të ambulancës, do të dërgoheni deri te institucioni adekuat shëndetësor, në rrethinën tuaj më të afërt.

Përveç për infektimet seksualisht të transmetueshme, në ambulancën mobile ofrohen edhe këto shërbime:



2. PAP-testi

PAP-testi është metoda e vetme me të cilën herët zbulohet ndryshimi i qelizave në grykën e mitrës dhe kanceri në grykën e mitrës. Ky test mundëson që të zbulohen ndryshimet e grykës së mitrës para se të paraqiten shenja të dukshme të kësaj sëmundjeje. PAP-testi i zbulon edhe infektimet e shkaktuara nga kërpudha Candida dhe nga paraziti Trichomonas.

Rezultatet nga të gjitha hulumtimet (edhe nga testet për infektimet seksualisht të transmetueshme dhe nga PAP-testi) fitohen për dy javë, kur ambulanca mobile përsëri do të kthehet në vendin tuaj të banimit. Me dhënien e rezultateve mjeku do ta shkruajë terapinë falas, varësisht nga rezultatet e fituara.



3. EHO-KONTROLLI GJINEKOLOGJIK

EHO-kontrolli mundëson që të zbulohen ndryshimet që ndodhin në mitër, vezoret dhe te vezë përçuesit (paraqitja e cisteve, tumorit dhe ndryshimeve tjera të organeve riprodhuese).



4. KONTRACEPSIONI

Kontracesioni paraqet përdorimin e metodave dhe mjeteve me të cilat pengohet shtatzënia e padëshiruar. Ekzistojnë mjetet të ndryshme kontraceptive, ndërsa në ambulancën mobile do të ofrohen këto:

- tableta për kontracesion (kontracesion hormonal oral)
- pad intrauterine – spiralë
- prezervativ
- kontracesion urgjent

(Kontracesioni urgjent paraqet mënyrën me të cilën pengohet shtatzënia e padëshiruar me marrjen e tabletave adekuate, më së voni 72 orë nga marrëdhënia e pambrojtur seksuale).



5. INFORMIMI DHE KËSHILLIMI

Specialisti gjinekolog-akusher do t'ju informojë dhe këshillojë për të gjitha që ju intereson lidhur me infektimet seksualisht të transmetueshme, HIV dhe metodat dhe mjetet për kontracepsion (pengimin e shtatzënisë së padëshiruar).



6. MATERIALET EDUKATIVE

Në ambulancën mobile mund të merrni broshurë me informata për mbrojtje dhe avancimin e shëndetit tuaj seksual dhe riprodhues.

SHËRBIME FALAS

Të gjitha shërbimet që ofrohen në ambulancën mobile janë FALAS. Gjatë kësaj, që t'i shfrytëzoni shërbimet në ambulancë, nuk ju nevojiten kartonët, libreza shëndetësore, letra e njoftimit ose çfarëdo dokumenti për identifikim personal.

SHËRBIMETË BESUESHME

Familja, të afërmit dhe miqtë nuk mund ta marrin vesh për rezultatet nga testet që janë bërë në ambulancën mobile. Gjatë kontrollit dhe këshillimeve është e lejuar prezenca vetëm e mjekut dhe e motrës medicinale. Të gjitha të dhënat e fituara gjatë këshillimit dhe bisedës me mjekun, duke përfshirë edhe rezultatet nga testet, janë sekrete dhe nuk guxon të ndahen me persona tjerë, përveç me kërkesën tuaj.

ORARI I SHËRBIMEVE

Informata të hollëshisme (ku saktësisht do të parkohet automjeti, cilën ditë dhe në ora sa) mund ta merrni nga organizata lokale joqeveritare, motrat patronazhe ose nga personi që ju ka shpërndarë këtë broshurë.

Për informata plotësuese paraqituni në numrin e telefonit 02/3176-950 ose dërgoni postë elektronike:
mobilnaambulanta@hera.org.mk

Забележете го датумот и времето кога мобилната амбуланта повторно ќе биде во вашето место на живеење.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Shkup, 2013



Investing in our future
The Global Fund
To Fight AIDS, Tuberculosis and Malaria

Своите опции тука се ставате на одговорност и не се гарантирани. Ставите и резултатите на Фондационот Фонд за Борба против СПИД, Туберкулоза и Маларија, негу кои постојат одговорности или детерминација за ниво на вложувањето, вклучуваат информација од Фондационот Фонд за Борба против СПИД, Туберкулоза и Маларија.



МИНИСТЕРСТВО
ЗА ЗДРАВСТВО



X. E. P. A.



A Member Association of
IPPF International
Planned Parenthood
European Network